



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I83-2

Prot.

Tiranë __18__/_12__/_2025

Nr. Dok. 202503644/2

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Qendrën Provizore të Pritjes së migrantëve të parregullt në Grehot dhe Kakavijë, në varësi të Drejtorive Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM) në Gjirokastrë.*

Drejtuar: Drejtues i Lartë Sajmir MUÇA
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

TIRANË

Drejtues i parë Elton ÇATO
DVKM në Gjirokastrë

GJIROKASTËR

Të nderuar zotërinj,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, si dhe duke vlerësuar angazhimin tuaj dhe të institucionit që ju drejtoni, në vijim po ju njohim me gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi që zhvilloi institucioni i Avokatit të Popullit në Qendrat Tranzit të Pritjes së Migrantëve të parregullt në Grehot dhe Kakavijë, në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin (DRKM) Gjirokastrë.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Qendrën Provizore të Pritjes dhe Akomodimit të Migrantëve të parregullt në Kapshticë, në varësi të Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin, Gjirokastrë, në datën 15.10.2025 sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, znj. Lindita Dedegjoni dhe z. Vullnet Topalli, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve infrastrukturore në Qendrat Tranzit të pritjes së migrantëve të parregullt të ngritura në Grehot Gjirokastrë, në lidhje me respektimin e lirive dhe të drejtave të migrantëve të parregullt që hyjnë nga pikat kufitare me shtetin e Greqisë, si dhe trajtimin dinjitoz dhe njerëzor të tyre, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për këtë qëllim. Objekt i inspektimit, ishte edhe verifikimi i zbatimit të

rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i kryer në vitin 2024¹.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, në Qendrat Tranzit të pritjes së migrantëve të parregullt, në mungesë të Drejtorit DRKM Gjirokastrë, grupi i punës u takua me shefin e sektorit të kufirit në DRKM z. Fadil Veli, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Shefi i sektorit të kufirit, pasi u njoh me qëllimin e vizitës inspektuese, informoi grupin e inspektimit në lidhje me garantimin e të drejtave të migrantëve të parregullt që hyjnë në Shqipëri nga pikat e kalimit të kufirit me Greqinë (PKK Kakavijë dhe PKK Tre Urat në Përmet) dhe identifikohen në kufirin e gjelbër dhe në territor, për kushtet infrastrukturore në qendrat e pritjes të migrantëve, zbatimin e procedurave të intervistimit dhe të përzgjedhjes si dhe, ofrimin e shërbimit shëndetësor, shërbimin psikologjik, furnizimin me materiale për veshje dhe për fjetje, furnizimi me ushqim catering për 24 orë etj.

Nga informacioni u evidentua bashkëpunimi i ngushtë i departamentit për kufirin dhe migracionin pranë DPPSH me UNHCR, në plotësimin e kushteve materiale dhe ofrimin e shërbimeve për migrantët e parregullt. Në bazë të marrëveshjes, nëpërmjet financimit të UNHCR, janë ngritur qendrat provizore të pritjes së migrantëve në Grehot dhe Kakavijë. Ndërsa, ofrimi i shërbimeve në këto qendra dhe plotësimi i stafit me mjek, infermier, psikolog, punonjës kulturor, sanitar dhe mirëmbajtës, ofrohet nga CARITAS me zyra në Qarkun e Gjirokastrës. Koha e qëndrimit të migrantëve të parregullt në këto mjedise është deri në 24 orë. Stafi i kontraktuar nga CARITAS punon me kohë të pjesëshme, në varësi të fluksit të pritjes së tyre në këto qendra.

Sipas informacionit, për periudhën Janar - Tetor 2025, nga shërbimet e DVKM Gjirokastrë janë kapur **320 shtetas** të huaj imigrantë të parregullt, në afërsi të kufirit të gjelbër të vendit tonë **277** persona dhe në territor **43** persona. Të gjithë këta persona kanë hyrë në territor për herë të parë. Nga **320** imigrantë të parregullt, 300 janë meshkuj, 19 gra dhe 1 i mitur i pa shoqëruar. Krahësuar me vitin e kaluar ka pasur një rritje të lehtë me 39 persona më shumë. Numrin më të lartë të imigrantëve të parregullt e zënë persona nga Siria, Pakistani, Bangladeshi, Afganistani, Egjipti, Maroku, Palestina, Iraku, Turqia dhe Nepali.

Qëllimi i imigrantëve të huaj është që pasi kalojnë kufirin (në rrugë apo shtigje që nuk kontrollohen nga forcat kufitare dhe FRONTEx), ata hyjnë në territorin e Shqipërisë duke vazhduar lëvizjen në drejtim të pikave të tjera kufitare në veri të vendit tonë në drejtim të Kosovës apo Malit të Zi, me synimin që të mbërrijnë në vendet e BE-së, duke e konsideruar Shqipërinë si një vend tranzit.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, sipas informacionit të DVKM Gjirokastrë, si dhe përgjigjes të dërguar nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në DPPSH², rezulton se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi për vënien në funksion të të gjitha dusheve në qendrën tranzit të pritjes së migrantëve të parregullt Grehot, si dhe mbatja e ambienteve sa më të pastra nga ana higjieno-sanitare.

¹ Me shkresën. K4/I82-2 prot., datë 23.12.2024 dërgohet Departamentit për Kufirin dhe Migracionin "Rekomandime për inspektimin e kryer në DRKM Gjirokastrë".

² Shkresa nr.90/1 prot., datë 27.01.2025, të Drejtorisë Vendore për kufirin dhe migracionin Gjirokastrë, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit.

2. Ishte zbatuar rekomandimi për plotësimin me korrektësi të rubrikës “*Të dhëna për njoftimin e familjarëve/afërmyve*” në “*Regjistrin e personave të shoqëruar*” dhe evidentimi i tyre në këtë regjistrë sipas kërkesave të parashikuara në procedurat standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 dhe sigurimin e monitorimit të vazhdueshëm të tyre si dhe nisjen e procedurave për evidentimin e përgjegjësve në lidhje me këtë çështje.
3. Ishte zbatuar rekomandimi për afishimin në ambientet e dhomës të shoqërimit, të listës të përditësuar me avokatë mbrojtës të miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe organi i prokurorisë, me qëllim sigurimin e avokatëve kryesisht që nga momenti i privimit të lirisë të personit, në rastin kur i shoqëruari/ndaluari/arrestuari nuk ka mundësi financiare të mbrohet me avokat kryesisht.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për afishimin në ambientin e dhomës së shoqërimit të Drejtoisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit, komunikimin e shtetasve të shoqëruar, me institucionin në lidhje me adresimin e ankesave të tyre.
5. Ishte zbatuar rekomandimi për afishimin me stendë kornizë në korridorin dhe në dhomat e shoqërimit të të drejtave që gëzojnë të shoqëruarit në mjediset e policisë së shtetit, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 367, datë 19.02.2024, për respektimin dhe garantimin e të drejtës për personat e shoqëruar për tu informuar mbi të drejtat ligjore që kanë, në ambientet e Policisë së Shtetit”.
6. Ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese brenda dhomës të shoqërimit në DVKM, sipas parashikimeve në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, nga strukturat për kufirin dhe migracionin, në bashkëpunim me autoritetet shtetërore përgjegjëse, që kanë për qëllim trajtimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të planifikojnë fonde për ndërtimin e një Qendre Kombëtare pritëse për këtë kategori.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Drejtoinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.

3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi midis strukturave shtetërore për kufirin dhe migracionin, për nënshkrimin e një protokolli dypalësh ripranimi mes Shqipërisë dhe Greqisë, për të bërë të mundur kthimin e migrantëve të parregullt që hyjnë nga kufiri me Greqinë, sipas provave, dokumenteve dhe procedurave të dakortësuara mes të dy shteteve.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të DVKM, për shtetasit gra të shoqëruara të ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.

Për sa më sipër, u informuam se, nga ana e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë, ishin bërë përpjekjet e nevojshme duke u drejtuar organeve eprore me kërkesa për të mundur mbështetje financiare të projektit për rehabilitimin e qendrës provizore Gos Kakavijë dhe Qendrës Grehot Gjirokastrë, në lidhje me respektimin e lirive dhe të drejtave të migrantëve të parregullt që hyjnë nga pikat kufitare me shtetin e Greqisë, si dhe trajtimin dinjitoz dhe njerëzor të tyre, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, për këtë qëllim.

Përsa i takon procesit të intervistimit dhe të përzgjedhjes së migrantëve të parregullt, nga verifikimi i dokumentacionit të mbajtur nga punonjësit e policisë kufitare, rezultoi se, ato ishin zhvilluar konform procedurës së punës të Sektorit për Migracionin, gjithsej **320** për shtetas. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes u evidentua se, ishin lëshuar:

- ❖ Urdhër Largimi vullnetar për **300** shtetas;
- ❖ Kërkesa për Azil në RSH **10** shtetas;
- ❖ Ndaluar në QMH Karreç, Durrës me Urdhër Dëbimi **9** shtetas;
- ❖ Shoqëruar në qendrën sociale të pritjes në Bashkinë Gjirokastrë **1** i mitur i pa shoqëruar.

Sikurse konstatohet nga statistikat për vitin 2025, nga strukturat e policisë për migracionin në këtë drejtori kanë referuar një numër shumë të vogël të kërkesave për azil. Në përfundim të procedurave të përzgjedhjes, migrantët e parregullt që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare shoqërohen me automjetet e policisë dhe dërgohen në Qendrën e Hapur për pritjen e Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, deri në miratimin ose refuzimin e kërkesës për azil në RSH.

Sipas informacionit që disponon DVKM Gjirokastrë, këta shtetas ende janë në proces dhe në pritje të miratimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare nga Drejtoria e Azilit, të Huajve dhe Shtetësisë në Ministrinë e Brendshme³. Nga informacioni u evidentua gjithashtu se, nuk përjashtohet mundësia që këta shtetas mundet që edhe të largohen nga Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, për shkak se afati i përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës nga autoriteti përgjegjës shkon deri në 6 muaj, afat i cili edhe mund të shtyhet në rastet kur situata e azilkërkuesit në shtetin e origjinës është e paqartë. Por, në çdo rast, duke llogaritur afatet e parashikuar në ligjin nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët përfundon shqyrtimin brenda afatit maksimal kohor prej 21 (njëzet e një) muajsh nga paraqitja e kërkesës⁴.

³ Neni 28, pika 1 e ligjit nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar: “1 Procedura për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, si rregull, zgjat 6 (gjashtë) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës”.

⁴ Neni 28, pika 4 e ligjit nr.10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Një problematikë e përsëritur nga vitet e kaluara, por që u evidentua edhe nga inspektimi për vitin 2025, ka të bëjë me kushtet infrastrukturore dhe trajtimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar që identifikohen nga strukturat e policisë në kufirin e gjelbër dhe në territor. Kjo kategori, pasi identifikohen në territorin e vendit tonë, shoqërohen menjëherë pranë qendrës së pritjes të migrantëve të parregullt dhe intervistohen nga punonjësit e migracionit në bashkëpunim edhe me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Gjirokastrë. Në përfundim të procedurës të intervistimit, kur arrihet në konkluzionin se i huaji është i mitur, kryhen menjëherë procedurat për ti akomoduar në Qendrën Sociale të kësaj bashkie.

Sipas informacionit të punonjësve të migracionit, njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve kryen menjëherë vlerësimin fillestar për secilin rast, nëpërmjet verifikimit të gjeneraliteteve, të vendbanimit dhe të shtetësisë së tij, si dhe përgatit një raport të hollësishëm informues mbi arsyet e hyrjes dhe qëndrimit të pashoqëruar në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky raport përgatitet brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i raportimit të rastit, me qëllim caktimin që në fillim të një kujdestari ligjor për fëmijën e pashoqëruar nga gjykata kompetente dhe më tej, raporti i përcillet Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, sipas “Formatit tip” të referimit të rastit, si autoriteti shtetëror përgjegjës, për të garantuar funksionimin e sistemit të integruar të mbrojtjes për fëmijët e pashoqëruar⁵.

Gjithë procesi i marrjes së informacionit nga fëmija, bëhet me ndihmën e një psikologu apo të një të rrituri, që gëzon besimin e të miturit, dhe në gjuhën që ai kupton, si dhe nëpërmjet ofrimit të përkthyesit, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Lista e plotë e përkthyesve dhe psikologëve, është e miratuar nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në dispozicion të strukturave të Mbrojtjes së Fëmijëve për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër u evidentua se, menaxhimi i rasteve për fëmijët e huaj të pashoqëruar që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, nga punonjësit e policisë për kufirin dhe migracionin në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashkinë Gjirokastrë. Ky proces përmban edhe hartimin e një Plani individual për mbrojtjen e fëmijës, i cili përfshin shqyrtimin e rrezikut për trafikimin e fëmijës, si dhe sigurimin e regjistrimit nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin të kërkesës për azil e referimin përkatës të saj, tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Ministrinë e Brendshme.

Problematika qëndron në faktin se, në qendrat sociale të bashkive, mungojnë kapacitetet për akomodimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar, sidomos në rastet kur ka flukse migratore. Qendra Sociale në bashki, është sipas modelit “*qendër e hapur*” dhe fëmijët e pashoqëruar qëndrojnë aty nga 24 – 72 orë. Pajisja me materiale fjetje, rroba për veshje, si dhe ushqim katering sigurohet nga UNHCR nëpërmjet CARITAS në bashkëpunim me Bashkinë Gjirokastrë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga interesi më i lartë i mbrojtjes së fëmijës dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë, ka disa vite që ka rekomanduar ngritjen e një Qendre Kombëtare pritëse të veçantë për fëmijët e huaj të pashoqëruar, por deri më sot ky rekomandim **nuk** është zbatuar dhe për më tepër, ende nuk ka një reagim nga institucionet shtetërore përgjegjëse të ngarkuara me ligj si MSHMS dhe ASHDMF në bashkëpunim

⁵ VKM nr.111/2019 “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”, Kreu II përcaktohen procedurat dhe rregullat e kthimit të fëmijëve të pashoqëruar, të huaj apo pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

me Departamentin për Kufirin dhe Migracion dhe organet e qeverisjes vendore në Gjirokastër dhe Korçë.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të vlersonte, ndërtimin e një **Qendre Kombëtare për pritjen e fëmijëve të huaj të pashoqëruar**, me qëllim që të garantohen të drejtat e fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe t'u ofrohet atyre mbrojtje më e lartë e mundshme, sipas një sistemi të integruar mbrojtjeje dhe koordinimi efikas të të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës.

Një problematikë e ngritur ndër vite nga Avokati i Popullit, nisur nga inspektimet periodike të zhvilluara në qendrat e pritjes së migrantëve të parregullt, si dhe nga raportet e ekspertëve të jashtëm të institucionit tonë që monitorojnë situatën e prurjeve migratore në kufi, ka të bëjë me **mungesën e fondeve buxhetore** në drejtoritë vendore për kufirin dhe migracion, me qëllim mirëmbajtjen e qendrave të pritjes, kryerjen e investimeve, si dhe mbështetjen me stafe për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për migrantët që akomodohen në këto qendra. Që në fillimet e ngritjes dhe ndërtimit të këtyre qendrave, stafi mbështetës dhe investimet në qendrat e pritjes së migrantëve të parregullt, janë siguruar nga donatorët e huaj dhe organizatat ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë.

Duke qenë se, flukset migratore do të jenë prezente në kufirin dhe territorin e Shqipërisë edhe për vitet në vijim, është e domosdoshme që të hartohen dhe të planifikohen fonde buxhetore për qendrat tranzit të pritjes së migrantëve, me qëllim që eksperiencia e deritanishme e krijuar në këto qendra të konsolidohet, por njëkohësisht për të siguruar që të ruhet dhe të funksionojë regjimi për mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe për të krijuar dhe mirëmbajtur sisteme shtetërore azili, që respektojnë parimet e mbrojtjes dhe mund t'u përgjigjen me efektshmëri sfidave moderne.

Respektimi i lirive dhe i të drejtave të shtetasve të huaj për mbrojtje ndërkombëtare, janë të parashikuara në Kushtetutën e RSH, legjislacionin kombëtar dhe në konventat ndërkombëtare, ndaj ato janë të pranueshme dhe janë detyrim për institucionet dhe organet shtetërore në nivel qendror dhe atë vendor. Kushtetuta e RSH përcakton qartë se: *“Të drejtat e liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptar vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”*⁶.

Qendra Tranzit e Pritjes së Migrantëve të parregullt në Grehot

Kjo qendër është e ndërtuar në vitin 2017 nëpërmjet një financimi grant të Fondit të Migrantëve dhe Refugjatëve përmes Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, në kuadër të projektit *“Përmirësimi i kapaciteteve të pritjes dhe aksesit në shërbime për migrantët dhe refugjatët që hyjnë në Shqipëri”*.

⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenin 16, pika 5

Ajo është e ndërtuar sipas modelit me **konteiner**, me disa njësi të ndara më vehte:

- ❖ Konteinerët për akomodimin e migrantëve me 15 dhoma dhe kapacitet për 60 persona;
- ❖ Mjedisi (2 dhoma) për kryerjen e intervistave të përzgjedhjes nga specialistët për migracionin;
- ❖ Mjedisi (menza dhe kuzhina) për ngrënien e ushqimit;
- ❖ Mjedisi (ambulanca) për kryerjen e vizitave mjeksore nga mjeku;
- ❖ Mjedis i veçantë për argëtimin e fëmijëve; si dhe,
- ❖ Ambienti për dushe dhe higjenën personale.

Dhomat që shërbejnë për qëndrimin dhe fjetjen e migrantëve, janë të kompletuara me nga 2 krevatë (marinari) për 4 persona në secilën dhomë dhe të pajisura me dyshekë, batanije dhe jastëkë, si dhe në mes kanë një tavolinë me stola për qëndrimin ulur të personave. Çdo dhomë është e pajisur edhe me kondicioner për ngrohje dhe ftohje sipas stinëve. Në rastet kur në dhoma, akomodohen një familje me mbi katër persona, kushtet në dhoma vështirësohen, por në çdo rast kjo bëhet me pëlqimin e vetë migrantëve. Pajisjet e hotelerisë janë të kompletuara nga CARITAS.

Mjedisi ku zhvillohen intervistat e përzgjedhjes të migrantëve është në një konteiner më vete. Ai kishte dy dhoma, ku në njërin anë punonin punonjësit e policisë kufitare që zhvillonin procedurat e intervistimit dhe përzgjedhjes së migrantëve, ndërsa në dhomën tjetër punon ekipi i ekspertëve të FRONTEX-it (në përbërje të të cilit është edhe një oficer i policisë shqiptare nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin). Ekspertët e policisë dhe të FRONTEX bashkëpunonin me njëri-tjetrin gjatë gjithë procesit të intervistimit deri në momentin e vendimarrjes për secilin fëmijë të pashoqëruar.

Mjedisi i kuzhinës është i ndarë në dy ambiente, mencën për ngrënien e ushqimit dhe në ambientin e gatimit. Menca ishte e kompletuar me tavolina, karrige, lavaman dhe me çezëm me ujë të rrjedhshëm. Ndërsa, ambienti i gatimit ishte i kompletuar me pajisje elektrike për gatim dhe për ngrohjen e ushqimit, për rastet kur ushqimi sigurohej nga vetë migrantët. Sipas marrëveshjes, ushqimi përgatitej me katering dhe servirej nga CARITAS, për tre vakte në 24 orë.

Qendra e pritjes ka dhe një mjedis të veçantë (dhomë) për kryerjen e vizitave mjeksore. Mjeku ishte siguruar nga CARITAS nga radhët e mjekëve të Spitalit Rajonal Gjirokastrë dhe punon me kontratë me kohë të pjesëshme, në varësi të flukseve migratore në pikën e kalimit të kufirit Kakavijë. Dhoma e vizitave mjekësore është e kompletuar me krevat, tavolinë pune, karrige, pajisje mjekësore ambulatorë të nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë, ndërsa në rastet e rënda shëndetësore, ata shoqëroreshin për në Spitalin Rajonal të Gjirokastrës. Në këtë dhomë, ndodhej edhe një raft për mbajtjen e ilaçeve të emergjencës, të cilat nga verifikimi i grupit të inspektimit ishin brenda afatit të skadencës. Mjeku mbante një regjistër ku evidentonte të gjitha rastet e vizitave mjeksore, diagnozat dhe kurën me ilaçe për secilin prej tyre.

Qendra ka dhe një dhomë të vogël, që përdoret si ambient argëtimi për fëmijët dhe është e kompletuar me tavolina e karrige të vogla, si dhe lodra me qëllim për të kaluar kohën, por kryesorja për të ulur nivelin e lartë të lodhjes, ankthit, traumave dhe stresit të rënduar psikologjik të fëmijëve, të shkaktuar nga udhëtimet e gjata në këmbë.

Qendra e pritjes kishte tualete të ndara më vete, për burrat dhe për gratë. Tualetet, ishin të pajisura me rubineta me ujë të rrjedhshëm, nyje hidrosanitare dhe hidrantë zjarri, por kishte nevojë për t'u mbajtur pastër nga ana higjieno-sanitare.

Gjithashtu, kjo qendër kishte dhe dushe të ndara më vete për burra dhe gra, që mundësonin larjen e trupit të migrinteve të akomoduar në këtë qendër. Por gjatë inspektimit në këtë ambient, u konstatua se vetëm 2 dushe ishin funksionale ndërsa 2 të tjerët mungonte koka e dusheve dhe ishin jashtë funksionit.

Qendra Tranzit e Pritjes së Migrintëve të parregullt në Kakavijë

Në pikën e kalimit të kufirit në Kakavijë, ndodhen disa ambiente të Grupit Operacional Special (GOS) Kakavijë. Ajo ka një godinë, e cila nga viti në vit është duke u amortizuar, godina aksesohet me vështirësi nga mjetet e transportit për shkak të gjendjes së keqe të segmentit rrugor, ndërsa kushtet e brendshme të godinës dhe ndriçimi janë përmirësuar së fundmi nga një investim i IOM-it që ka kryer në godinën e GOS Kakavijë.

Segmenti nga pika kufitare Kakavijë drejt GOS, lidhen nëpërmjet një tuneli të ndërtuar në periudhën para viteve 1990, i cili është i pandriçuar. Kjo e bën të vështirë trajtimin e rasteve të transferimit në këmbë të migrintëve nga pika e kalimit të kufirit për në godinën e GOS Kakavijë, sidomos gjatë natës.

UNHCR-së ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të godinës së GOS dhe ambienteve të tjera funksionale, për të kryer rehabilitimin e godinës, ripërcaktimin e mjediseve të intervistimit, vënien në funksion të disa mjediseve të braktitura dhe harmonizimin e të gjitha nevojave. Me qëllim përmirësimit të kapaciteteve në GOS Kakavijë, për të përballuar flukset migratore në pikën e kalimit të kufirit. Ndërsa, në vitin 2020 janë vendosur në Stacionin Policor të Kakavijës në GOS edhe 3(tre) kontier, me njësi akomodimi dhe njësi hidrosanitare, me kapacitet për 18 persona.

Gjithashtu, në këtë qendër, ndodhet edhe një ambient që shërben si ambulancë ku kryhen vizitat mjekësore nga mjeku, e pajisur me pajisje mjekësore, krevatë, karrige dhe raft për mbajtjen e medikamenteve. Stafi mbështetës edhe në këtë qendër sigurohet nga CARITAS.

Ambienti i shoqërimit dhe trajtimi i të shoqëruarve në Drejtorinë Vendore Për Kufirin dhe Migracionin në vijim(DVKM).

Ambienti i shoqërimit në DVKM Gjirokastër, **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, dhe procedurave standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e Policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022⁷.

Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm⁸ në strukturën e DVKM-ve, u rikthyen sektorët e hetimit. Kjo detyron punonjësit e policisë kufitare që për shtetasit e identifikuar në pikat e kalimit të kufirit në konflikt me ligjin dhe që plotësojnë kushtet për shoqërimin e tyre në mjediset e policies, duhet të trajtohen nga strukturat e policisë, sipas të drejtave që gëzojnë personat e shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim, si dhe të mbahen në ambiente me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme të dedikuara për qëndrimin e personave.

⁷ Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde në lidhje me kushtet e mbajtjes dhe sigurinë e personave të shoqëruar.

⁸ Urdhër nr. 47, datë 14.04.2023 i Ministrit Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit”.

Ambienti i ri i shoqërimit i krijuar në DVKM Gjirokastrë, ndodhej në ambientet e brendshme të godinës. Në këtë mjedis ndodhej vetëm 1 (një) dhomë shoqërimi për personat e rritur (burra). Në rastet e shoqërimit të personave gra dhe të mitur, sipas informacionit, në mungesë të dhomave të shoqërimit, ata do të mbahen në zyrat e punës të specialistëve të krimeve të ngarkuar për kryerjen e veprimeve procedurale.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për gra dhe të miturit⁹ në konflikt me ligjin është një problem thelbësor që paraqitet në këtë DVKM, duke mos siguruar garantimin e lirive, të drejtave dhe standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin në mjediset e policisë, si dhe nevojave fizike dhe psikologjike, kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

Dhoma e shoqërimit është me sipërfaqe 16 m² dhe e kompletuar me stola për qëndrimin ulur të personave dhe tavolinë pune për specialistët e policisë. Kapaciteti i dhomës së shoqërimit ishte për mbajtjen e 6-8 personave. Dritarja e dhomës kishte përmasa të tilla që mundësonte ajrim e ndriçim të plotë natyral. Nga ana e jashtme, dritarja ka të vendosur një zgarë hekuri me shufra vertikale dhe horizontale. Ndriçimi elektrik i dhomës komandohej nga korridori i dhomave të shoqërimit me çelës të veçantë.

Dera e dhomës së shoqërimit për të rriturit, ishte me material prej druri në anën e brendshme dhe të jashtme të saj, është e përforcuar me një fletë llamarinë. Ajo mbyllet me çelës nga ana e jashtme e saj dhe çelësi mbahej nga punonjësi i zyrës të informacionit.

Dhoma e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare dhe të lyera. Në fund të korridorit të ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte çezmë me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Në ambientet e këtij institucioni mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedura standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.”*¹⁰

Në DVKM kishte gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh. Ambienti i shoqërimit nuk kishin sistem ngrohje/ftohje.

Në ambientin e shoqërimit ishin të instaluar 3 kamera sigurie nga të cilat 2 kamera në korridorin e dhomës së shoqërimit dhe 1 kamera brenda dhomave të shoqërimit, të cilat shërbejnë për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe dhomave të shoqërimit, si dhe monitorojnë veprimet që kryejnë punonjësit e policisë me personat e shoqëruar gjatë kryerjes së procedurave që nga hyrja në mjediset e policisë, qëndrimin në dhoma, si dhe gjatë marrjes në pyetje të tyre.

⁹ Kreu VI, pika 4 e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Dhoma e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për persona madhorë, mitur dhe femra, të cilat kanë sipërfaqe nga 16-20m², secila”*.

¹⁰ Dhoma e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare dhe të lyera. Në fund të korridorit të ambienteve të shoqërimit ndodhej një tualet, i cili ishte i pastër dhe kishte çezmë me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Në ambientet e këtij institucioni mungonte tualeti për gra, duke mos garantuar standardin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 procedura standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, ku parashikohet se: *“Brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.”*

Gjatë inspektimit u evidentua se situata me njohjen e të drejtave ishte përmirësuar dukshëm në këtë institucion, ku në korridorin e ambientit të shoqërimit ishin vendosur posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, të cilët ishin të afishuar edhe brenda dhomave të shoqërimit, me qëllim që të jenë të aksesueshëm nga personat e shoqëruar për tu njohur me këto të drejta. Gjithashtu në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 15.10.2025 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit 65 persona nga të cilët saktësisht 59 shtetas madhor, 5 gra dhe 1 të mitur në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 19 dhe 25/1 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Nga inspektimi u evidentua se, në mjedisin e dhomës të shoqërimit dhe në zyrat e punonjësve të policisë të drejtorisë, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të ekspozojnë dhunë apo mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve, për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë, për tu larguar me forcë nga këto ambiente etj.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte gjithashtu një dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se ata të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të polici Gjirokastër. Pyetja e të shoqëruarve kryhej në zyrat e punës të specialistëve të policisë.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i përsëritur në vite nga Avokati i Popullit referuar akteve ligjore në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare¹¹, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Në procedurat standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin Nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, shprehet qartë se: “Në mjedisin ku ndodhen dhomat e shoqërimit, duhet të krijohet dhe një dhomë për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar para se të akomodohen/futen në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë (personat që do të arrestohen/ndalohen)”, duke u shndërruar në rregull të detyruar për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit.

Ky ambient përveç kushteve të përcaktuara për dhomat e shoqërimit duhet të plotësojë edhe kushtin për instalimin e sistemeve dhe pajisjeve për regjistrimin elektronik audio dhe

¹¹ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste”. Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2018) 31 [par.20]. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806bf46f>.

video të të gjitha veprimeve procedurale që kryhen me personin e shoqëruar nga oficerët e Policisë Gjyqësore, para se personi të akomodohet në dhomat e sigurisë të DVP/komisariatit të policisë si i arrestuar/ndaluar¹².

Në raportin drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e CPT-së në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023 është evidentuar qartë nevoja e krijimit të dhomave të intervistimit: *“Në fakt, një strukturë e tillë mund të sigurojë një regjistrim të plotë dhe autentik të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në masë të madhe hetimin e çdo pretendimi për keqtrajtim. Ky fakt është në interes si të personave që janë keqtrajtuar nga policia, ashtu edhe të punonjësve të policisë që janë përballur me pretendime të pabaza se janë përfshirë në keqtrajtime fizike apo presione psikologjike.*

Në parim, regjistrimi audio-vizual duhet të mbulojë të gjitha fazat e marrjes në pyetje nga policia, duke përfshirë dhënien e informacionit për të drejtat në fillim të intervistës. Kjo do të sigurojë që marrja në pyetje nga ana e policisë të kryhet në përputhje me ligjin dhe do të ndihmojë në parandalimin e çdo praktike të nënshtrimit të personave të ndaluar në marrje në pyetje joformale përpara marrjes në pyetje zyrtare”.

CPT inkurajon autoritetet shqiptare të zgjerojnë aplikimin e regjistrimit audio-vizual të intervistave të policisë për marrjen në pyetje të të gjithë personave të shoqëruar”¹³.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë¹⁴. Përveç sa më sipër, Avokati i Popullit inkurajon pajisjen e qytetarëve me *“Kartën e të drejtave”* në rast shoqërimi në polici, që është një dokument me të cilin duhet të njihet çdo qytetar që shoqërohet në një institucion policie. Nëpërmjet *“Kartës së të drejtave”* qytetari informohet mbi të drejtat e tij përballë institucionit të Policisë së Shtetit në mënyrë që të jetë i ndërgjegjshëm për çdo formë abuzimi apo tejkalimi të kompetencave të punonjësve të policisë kundrejt tij.

Personat e ndaluar apo të arresuar, në përfundim të veprimeve procedurale nga specialistët e policisë të DVKM Gjirokastër, së bashku me dokumentacionin shoqërues të parashikuar në K.Pr. Penale (kryesisht letrën me të drejtat në formë të shkruar)¹⁵, dërgohen menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në DVKM, kishte *“Regjistër i evidentimit në të dhënave për personat e shoqëruar”* ishte i tipit *“Model nr. 1”* konform me procedurat standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* miratuar me

¹² Kreu VI, pika 4/i.1.1 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*.

¹³ Electronic recording of police intervistës (Regjistrimi elektronik i marrjes në pyetje nga ana e policisë) fq.13, <https://rm.coe.int/1680ae233b>.

¹⁴ CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

¹⁵ Neni 34/b i K.Pr. Penale.

Urdhërin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se:

Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme **nga 1 orë deri në 5 orë** në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë.

Në këtë institucion kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga verifikimi i këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë. Avokati i Popullit sqaron se ora e shoqërimit është ajo e vendosjes së personit në mbikëqyrjen policore dhe jo ajo e futjes brenda ndërtesës së institucionit. Për këtë arsye duhen marrë masat përkatëse.

Gjithashtu, në këtë Drejtori administrohej regjistër për të miturit e shoqëruar në konflikt me ligjin, ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, në të cilin u konstatua se të gjithë rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte dhe regjistri ishte i sekretuar.

Nga inspektimi, u konstatua se në këtë institucion kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 24 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në zyrën e informacionit, ndodhej edhe një regjistër për takimet me avokatin kur kërkohej nga të shoqëruarit, si dhe karta e të drejtave të personave të shoqëruar apo ndaluar/arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me funksion parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit, ndihma juridike dhe psikologjike

Migrantët e parregullt dhe shtetasit në konflikt me ligjin, që identifikohen në pikat e kalimit të kufirit, i nënshtrohen një procedure trajtimi sipas legjislacionit vendas dhe atij të përafuar me vendet e BE-së. Ajo është e bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 174, datë 12.09.2022 “Mbi Procedurat e Trajtimit të të Huajve me Qëndrim të Parregullt në Territorim e Republikës së Shqipërisë”, në procedurën standarde “Për përzgjedhjen e të huajve të parregullt”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. 172, datë 08.02.2018, si dhe në procedurën standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë me nr. 894 datë 19.07. 2022.

Në rastin e migrantëve të parregullt, punonjësit e policisë kufitare të DVKM Gjirokastrë kryejnë procedurën e intervistimit dhe të përzgjedhjes (screening process), në varësi të flukseve migratore, në mjedisin e intervistimit që ndodhet në ndërtesën e GOS Kakavijë ose në Qendrën e Përkohshme Grehot. Edhe në rastet kur migrantët e parregullt

identifikohen në zonën e Përmetit (përmes PKK në Tri Ura), ata shoqërohen me automjetet e policisë, për tu trajtuar pranë Qendrës tranzit të pritjes së migrantëve në Grehot.

Në GOS Kakavijë, ambienti i intervistimit nuk ka mundësi hyrjeje nga njëra anë dhe dalje nga një anë tjetër, të personave që intervistohen dhe kjo krijon konfuzion dhe pamundëson përpunimin e shpejtë të të dhënave të grupeve të migrantëve me shumë persona, në raste të ardhjeve masive të migrantëve.

Ndërsa, në Grehot, ambienti i intervistimit i plotëson kushtet bazike të punës për punonjësit e policisë së kufirit dhe migracionit, me qëllim kryerjen e procedurave për identifikimin, intervistimin dhe përzgjedhjen e migrantëve. Në këto ambiente, janë të pranishëm dhe asistojnë me ndihmesën e tyre punonjësit e policisë kufitare edhe ekspertët e FRONTEX-it. Në varësi të nevojës që paraqesin migrantët e parregullt, por në sidomos në rastin e intervistimit të të miturit, i pranishëm në ambientin e intervistimit është edhe psikologu që sigurohet nga CARITAS.

Në procesin e intervistimit dhe procedurës të përzgjedhjes së migrantëve të parregullt, është prezent dhe eksperti i jashtëm i Avokatit të Popullit i cili monitoron procesin që nga identifikimi i tyre në kufirin e gjelbër dhe në territor, deri në momentin e vendimarrjes apo plotësimit të urdhërave të largimit të tyre nga territori i vendit tonë. Roli i tij konsiston në monitorimin e procesit të pritjes së migrantëve, duke kërkuar zbatimin e standardeve më të larta të punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit për respektimin e të drejtës së tyre për mbrojtje ndërkombëtare, e cila garantohen nga dispozitat ligjore kombëtare dhe aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim. Në ditën e inspektimit, nga informacioni i marrë rezultoi se nuk kishte patur ankesa në lidhje me këtë proces.

Nga informacioni dhe intervistat e zhvilluara me punonjësit e policisë kufitare, mbetet problematikë mungesa e përkthyesve të licencuar për disa gjuhë specifike si Dari, Fars, etj., pavarësisht zgjidhjes të siguruar nga CARITAS dhe FRONTEX nëpërmjet përkthimit online me përkthyes të këtyre gjuhëve. Ndaj, në shumicën e rasteve, komunikimi me migrantët bëhet në gjuhën angleze, aq sa mund të jetë e mundur ose në një gjuhë të përafërt me gjuhën e tyre.

Bazuar në kërkesat e ligjit 79/2021 “Për të huajt”, i ndryshuar, autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve dhe kthimet në Republikën e Shqipërisë është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin. Kjo strukturë shtetërore, gjatë vendimarrjes në lidhje me migrantët e parregullt, zbaton dispozitat e këtij ligji në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Por, nga analiza e këtij fenomeni dhe statistikave vjetore të prurjeve migratore, vihet re se, nga DVKM Gjirokastrë kemi një numër të lartë të “kthimeve” të migrantëve të parregullt në kufi dhe shumë pak numri i kërkesave për azil, për t’ju dhënë atyre një mundësi qëndrimi në Shqipëri.

Sipas informacionit të drejtuesve të DVKM Gjirokastrë, nënshkrimi i një protokollit dypalësh ripranimi me Greqinë, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të palës shqiptare, ende nuk është realizuar. Kjo do të bënte të mundur kthimin e migrantëve të parregullt në Greqi, sipas një protokollit të nënshkruar, por edhe mbi bazën e provave dhe dokumenteve të lëshuara nga pala e kërkuar dhe dakordësia mes dy shteteve.

Në rastin e shoqërimit të personave në konflikt me ligjin, kur ata e shikojnë të nevojshëm, punonjësit e policisë kufitare që kryejnë veprime proceduriale me të shoqëruarit, duhet të sigurojnë në çdo kohë avokatë mbrojtës, si dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor për këta

persona. Kur i shoqëruari është i mitur, marrja në pyetje duhet të kryhet detyrimisht në praninë e kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës dhe të psikologut.

Sipas informacionit të drejtuesve të policisë, kur i shoqëruari paraqet probleme shëndetësore, dërgohet menjëherë në urgjencën e Spitalit Rajonal në Gjirokastrës. Ndërsa, psikologu ofrohet nga Bashkia e Gjirokastrës ose nga shkolla e mesme e qytetit. Në rastin e kërkesës të të shoqëruarit për avokat mbrojtës, ai sigurohet nga lista e avokatëve të miratuar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në ambientin e shoqërimit.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenit 21, germa “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për planifikimin e fondeve në buxhetin e DVKM-ve ku janë ngritur qendrat tranzit të pritjes së migrantëve të parregullt, me qëllim forcimin e kapaciteteve të tyre me staf mbështetës, si dhe kryerjen e investimeve për mirëmbajtjen e këtyre qendrave.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat për kufirin dhe migracionin, në bashkëpunim me autoritetet shtetërore përgjegjëse, që kanë për qëllim trajtimin e fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të planifikojnë fonde për ndërtimin e një Qendre Kombëtare pritëse për këtë kategori, si dhe për plotësimin e stafit me psikologë, punonjës socialë për trajtimin e tyre, dhe staf policor për ruajtjen e tyre.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Drejtoinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrimin në dhomat e shoqërimit të ndara më vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.
4. Të vijohet puna midis strukturave shtetërore për kufirin dhe migracionin, për nënshkrimin e një protokolli dypalësh ripranimi mes Shqipërisë dhe Greqisë, për të bërë të mundur kthimin e migrantëve të parregullt që hyjnë nga kufiri me Greqinë, sipas provave, dokumenteve dhe procedurave të dakortësuara mes të dy shteteve.
5. Marrjen e masave të nevojshme me qëllim sigurimin e fondeve për zbatimin e një projekti rehabilitues për mjediset e GOS Kakavijë, të harmonizuara me nevojat funksionale dhe mundësitë që kanë mjediset ekzistuese.
6. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e një zyre për intervistimin apo marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët

e Policisë Gjyqësore, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera audio-vizive në këtë zyrë.

7. Marrjen e masave të nevojshme, për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të DVKM, për shtetaset gra të shoqëruara, ndaluara/arrestuara në konflikt me ligjin.
8. Marrjen e masave për garantimin në çdo rast të së drejtës së aplikimit për azil nga migrantët e parregullt në kufi, që të trajtohet çdo kërkesë e tyre sipas akteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi.
9. Marrjen e masave nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, për trajnimin e personelit të Policisë Kufitare, me qëllim njohjen e plotë të ligjeve që garantojnë të drejtat e emigrantëve të parregullt dhe të azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditë sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

dv